



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
MINISTRI

Nr. 16640/1 prot.

Tiranë, më 21.11. 2025

VENDIM

Nr. 13, datë 21.11. 2025

PËR

**SHPALLJEN E VENDIT VAKANT, TË ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS,
NË SHOQËRINË AKSIONARE AGROKREDIT**

Në mbështetje të ligjit nr. 9901/2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 570/2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 621/2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Agrocredit”, në pronësi të Ministrit të Financave,

VENDOSA:

1. Shpalljen e vendit vakant të anëtarit të Këshillit Mbikqyrës, në Shoqërinë Aksionare “Agrocredit”.
2. Kandidatët për anëtarë të Këshillit Mbikqyrës, duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:
 - a) Të jenë shtetas shqiptar;
 - b) Të zotërojnë diplomë universitare të nivelit “Master i shkencave” apo ekuivalent me të, në fushat juridike, ekonomike ose në fusha të tjera të përshtatshme me ushtrimin e funksionit;
 - c) Të kenë eksperiencë profesionale jo më pak se 5 vite pune;
 - d) Të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - e) Të mos kenë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;
 - f) Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:
 - a) Kërkesë me shkrim për aplikim;
 - b) Jetëshkrimi (CV);
 - c) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - d) Fotokopje të diplomës universitare që zotëron;

- e) Dokument që vërteton përvojën profesionale (fotokopje të librezës së punës, vërtetim punësimi etj);
 - f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore/dëshmi penaliteti;
 - g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - h) Deklaratë që nuk ka konflikt interesi, sipas legjislacionit në fuqi;
 - i) Deklaratë që nuk është i angazhuar në më shumë se dy këshilla mbikëqyrës, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.
4. Dorëzimi i dokumentacionit duhet të bëhet fizikisht, pranë zyrës së protokollit në Ministrinë e Financave, brenda 15 ditëve nga publikimi i shpalljes së vendit vakant.
5. Publikimi i kriterëve të vendit vakant, do të bëhet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.
6. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, si dhe Drejtoria TIK për Ministrinë e Financave, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Petrit Malaj

